Lezhë, më 20.12.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më dt. 20.12.2022, në orën 10:00,
në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF),
mbi mbledhjen e radhës të muajit Dhjetor 2022.
Mbledhja ishte njoftuar për t'u zhvilluar në
dt. 21.12.2022, por për arsye objektive mbledhja
u afrua për t'u zhvilluar sot, në dt. 20.12.2022.
Mbledhja u hap nga kryetari i K.B. Lezhë,
z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës
dhe projekt vendimin shtesë "Për trajtimin me bursë
të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet
arsimore publike për vitin shkollor 2022-2023",
Ndue Luli: Kalojmë për votim rendin e ditës
bashkë me pikën shtesë.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës
që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit
të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri
në 6% për periudhën 01-30 Nëntor 2022".
Kush ka diçka për diskutim?
Meqë nuk ka, e kalojmë p/vendimin për votim
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë (22)
Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës që
është projekt vendim "Për miratimin e nivelit të pagave
të administratës së bashkisë, të njësive administrative,
të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive
mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të
këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave".

* Erdhi këshilltari Aleksandër Kolvataj.

Agostin Marku: Me leje.

E kam thënë në çdo mbledhje kur është miratuar niveli i pagave. Niveli i shpërblimeve për kryetarët e fshatrave është qesharake, dhe mendoj se kjo është edhe një nga arsyet se pse disa prej tyre japin dorëheqjen. Kur vjen problemi për gjëra të tjera, kryetarët e fshatrave shikojnë deri në bujq dhe nuk është normale. Unë them që kjo duhet të ndryshojë. Unë kam qenë dhe jam për një administratë në numër të vogël por që shpërblehet mirë. Unë jam që pagat për të gjitha kategoritë e punonjësve të jenë në nivelin maksimal që na lejon ligji.

Ndue Luli: Jam i të njëjtit mendim me Agostinin. Ka pozicione, p.sh regjizor që paguhet si specialist i thjeshtë

Ermal Pacaj: Gjithashtu po është me vend propozimi i këshilltarit Agostinit. Normalisht kjo çështje delikate është, nuk është se është lënë për dëshirë. Financat e sëmura që kanë qenë në Bashkinë e Lezhës janë drejt shërimit tashmë. Realisht pagat e specialistëve janë rishikuar disa herë dhe kanë ndryshuar. Edhe qëllimi i Bashkisë ai është, që të shkojnë në nivelet që thotë Agostini, por financat nuk kanë qenë të mjaftueshme që të shkonim drejt kësaj.

Shpresojmë që në 6-mujorin e parë, ne të ezaurojmë pjesën e borxheve dhe të përmirësohet situata ekonomike.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim projekt vendimin.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës për këtë projekt vendim "Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2024-2026 dhe të buxhetit të vitit 2024".

Xhemal Hajdija: Është standardi ligjor, afatet, kompetencat, të gjitha janë të përcaktuara me ligj.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e hedhim në votim projekt-vendimin.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

* Erdhi këshilltari Marko Jaku.
* Erdhi këshilltarja Elsa Gazulli.

Ndue Luli: Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës për këtë projekt vendim "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të akorduar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".

Ermal Pacaj: Atëherë, janë detyrimet e prapambetura të disa punëve dhe investimeve që janë në proces nga Bashkia e Lezhës. Janë detyrime të vjetra dhe të reja.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë në votim projekt vendimin
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës për këtë projekt vendim "Për një shtesë e ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondeve të rindërtimit".
Marte Simoni: Këto fondet e rindërtimit, kanë përfunduar palletet për kanë mbaruar, me 1 kalim,
Ermal Pacaj: kjo është gjë tjetër në fakt.
Këto janë fonde për kanë ardhur nga ministria për t'i shpërndarë kontraktuesit, pallati i kulturës, konvikti dhe biblioteka. Kjo është në lidhje me projekt vendimin. Në lidhje me atë për po thua, vetëm 2 pjesë janë marrë në dorëzim, për janë palletet në bulevardin "Gjergj Fishta", në krah të mojit, sepse kanë përfunduar në afat, kurse pjesa tjetër janë në proces përfundimi për t'u marrë në dorëzim. Por kjo nuk do të thotë për atyre u mbaron detyrimi me marrjen në dorëzim sepse u mbahet një pjesë fondi për garanci dhe kanë për t'iu përgjigjur për çdo problematikë për mund të dalë.
Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë në votim projekt vendimin
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorim fondi të emergjencës për blerje pako ushqimore për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e reshjeve të shiut më dt. 20.11.2022 në Njësitë Balldre, Blinisht, Dajç të Bashkisë Lezhë".

Agostin Marku: Është shumë mirë që bëhet diçka e tillë, por mua më duket kjo vlerë shumë e vogël, sepse janë 50 familje të përmbytura me një vlerë totale 100 mijë lekë të reja. 20 mijë lekë të vjetra i takon për familje dhe është pak. Nuk e di situatën financiare të bashkisë, por n.q.s është e mundur, kjo shifër duhet të rritet.

Ermal Paçaj: Fatmirësisht, numri i familjeve të dëmtuara ka qenë shumë më i ulët se vitet e tjera. Praktikisht, ne i kemi trajtuar që ditën mbrapa pas përmbytjes këto familje. Janë asistuar edhe me ushqim për kafshët, ku kanë pasë nevojë. Kanë mbetur familje që janë më shumë në nevojë sesa janë të lagura. Këto realisht janë pak, por sado pak t'i ndihmojmë. Ne jemi ndihmuar me pako nga "Jetimat e Ballkanit" dhe nga bizneset. Pra, të gjithë bashkë japim diçka që t'i ndihmojmë sa më shumë. Ky është qëllimi.

Është çështje lehtë edhe kjo.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë në votim projekt vendimin.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që abstenoi.
Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve dhe mësuesve".
Hasan Muça: Unë jam i mendimit që ne ta miratojmë në parim, por para se të bëhet zbardhja e vendimit të bëhen disa korrigjime sepse ka ca pasaktësi të vogla te largësitë.
Ndue Luli: Jam i të njëjtit mendim me këshilltarin Hasan Muça, sepse në të vërtetë janë përcaktuar disa largësi që nuk janë reale.
Marko Jaku: Një pyetje, a ka kusht se sa nxënës do futen në këto mjete
Hasan Muça: S'i takon kësaj mbledhjeje.
Ndue Luli: Kështu ka dhe ka pasur ankesa vitet e kaluara për ngjeshje të fëmijëve nëpër furgona. Këto duhet t'i kërkojnë në vazhdimësi edhe prindërit dhe drejtoria e shkollës
Hasan Muça: Çështjen që ngre Marko, unë është herë e parë që e dëgjoj. Ne duhet të kemi një indicie që të veprojmë. Unë e mora si shqetësim dhe do e verifikoj.
Ndue Luli: Atëherë, me ndryshimet që duhet të bëhen te largësitë, kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës për éshtë projekt vendim "Për rishpyrtimin e bursave të nxënësve të viteve të ndëmjetme, të shkollës së mesme profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë, për vitin shkollor 2022-2023".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë p/vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë,
Kalojmë te projekt vendimi shtesë "Për trajtimin me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2022-2023"
Për arsye të numrit të kufizuar të bursave, janë trajtuar 8 nxënës me bursë të plotë dhe 21 me gjysmë burse.
Afestin Marku: N.q.s vijnë bursa të tjera nga Ministria dhe vijnë shpejt, këshilli mund të bëjë mbledhje përsëri vetëm për mos të digjen ato bursa.
Ndue Luli: N.q.s vijnë, mendimi im është që edhe online mund të mblidhemi, për mos të digjen, vetëm për këtë gjë. Besoj jemi dakord.
→ Këshilltarët shprehen dakordësinë.
Ndue Luli: E kalojmë në votim p/vendimin.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Te "Të ndryshme" kush ka diçka?
→ Kërkoi fjalën këshilltari Rigels Nicaj i cili

foli për buxhetin e Këshillit Bashkiak, i cili rrit performancën e këshillit

Në lidhje me këtë çështje dha sqarime z. Xhemal Haxhiu, përfaqësues i Drejtorisë së Financës në bashki.

→ Mbas këtyre diskutimeve, kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA LLUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI